

NJOFTIM PËR KONTRATË

PUNË

FURNIZIM

SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 20.03.2024

Nr i Prokurimit	KRURGJA-24-2351-5-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Kompania Rajonale e Ujësjetës GJAKOVA SH.A.		
Adresa Postare: 7,UÇK-së		
Qyteti: GJAKOVË	Kodi postar: 50000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Departamenti i Prokurimit	Telefoni: 049 732 866	
Email: prokurimi@kru-gjakova.com	Faksi:	
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Ndërrimi i gypave nga AC në PE, për tre rrugët e Rahovecit

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input checked="" type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input checked="" type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Rahovec – në rrugën Gëzim Hamza, Sheh Mehdini dhe Dëshmorët e Pashtrikut.

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Kontrate publike kornizë me disa operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Do te behet shtrirja e gypave kryesor, pastaj duhet të bëhen të gjitha kyçjet ekzistuese të shtëpive individuale, gjithashtu dhe rrjetet sekondare të cilat duhet të lidhen në gypin kryesor, i cili do të shtrihet me anë të këtij projekti. Punët e ndërrimit të gypit në këto rrugë, duhet të kryhen paralelisht dhe në kohë të njëjtë me punët që Komuna e Rahovecit është duke bërë për shtrirjen e rrjetit të ujërave atmosferik, me gypa DN600. Kjo për shkak se gypi i ujësjellësit do të shtrihet

anash gypit të ujërave atmosferik. Gjatë ekzekutimit të projektit do të bëhen Punët përgatitore dhe punët tokësore, punët instaluese dhe punë tjera të ndryshme të planifikuara në paramasë dhe testimi dhe dezinfektimi i gypsullës.

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45240000-1

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po Jo

Nëse *po*, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 145,320.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) Ndërrimi i gypave nga AC në PE, për tre rrugët e Rahovecit, do të ketë gjatësi totale prej L=2985m'. Në rrugën Sheh Mehdini do të shtrihet gypi i ri PE 100 RC Type 2, DN 110 16 bar me një gjatësi totale prej L=560 metra. Në rrugën Dëshmorët e Pashtrikut do të shtrihen gyp PE 100 RC Type 2, DN 110 16 bar me një gjatësi L=550 metra dhe Gyp PE 100 RC Type 2, DN 90 16 bar me një gjatësi L=840 metra, ndërsa në rrugën Gëzim Hamza do të shtrihen Gyp PE 100 RC Type 2, DN 110 16 bar me gjatësi L=1300 metra dhe Gyp PE 100 RC Type 2, DN 160 16 bar me një gjatësi totale prej L=285 metra.

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë 100 (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimitPo Jo *Nëse po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 %** e vlerës së kontratës**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):**

1. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, grupi duhet të prezentoj

a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës; b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe ose grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit; c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit. d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. Secili anëtar i grupit duhet të regjistrohet në platformën elektronike.

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratësPo Jo *Nëse po*, përshkrimi i kushteve të veçanta**III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2 të Dosjes së Tenderit.
2. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.	2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës (vlen për OE fitues dhe duhet të sjellet në formë fizike.
3. Vërtetimi i gjykates Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike.	3. Një formularë ekstrakt nga “regjistri gjyqësor”- Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike duke iu referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1 dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës (origjinal ose kopje e noterizuar) (vlen për OE fitues dhe duhet të sjellet në formë fizike).
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Numri Unik Identifikues	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Çertifikata e Numrit Unik Identifikues. (kopje)

2.Regjistrimi i TVSH-së	2.Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori ekonomik duhet të ketë perfunduar me sukses pune të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Lista e punëve nga Operatori Ekonomik duke saktësuar punët kryera, shumën e kontratës dhe kohën. Listën të bashkëngjiten si dëshmi (i) kur punët janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtyre punëve shërben kopja e certifikatës (certifikata ose raport pranimi ose referenca) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë. (ii) kur punët janë bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtyre punëve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i punimeve të tilla; (Referencat ose raportet e pranimi të punëve duhet të jete në përputhje me listen e prezantuar.)
2.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhojë staf të mjaftueshëm për realizimin me sukses të punimeve me këto kapacitete minimale 2.1. Një (1) Inxhinier i diplomuar apo Master i ndërtimtarisë me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit drejtimi konstruktiv apo hidroteknik, (i cili do të jetë edhe menaxher i këtij projekti), 2.2. Një (1) Bachelor i gjeodezisë me minimum 1 vjet përvojë pune pas diplomimit, 2.3. Një (1) saldues të Çertifikuar për saldimin e gypave PE dhe 2.4. Një ekip prej pesë (5) punëtorësh.	2.Një listë e stafit nga Operatori Ekonomik duke i bashkëngjitur dëshmitë për si në vijim Për piken 2.1 - Diploma e inxhinierit, CV dhe kontrata e punës ose referenca të punëdhënësve që dëshmojnë përvojën e punës, (në referenca duhet të jete të saktësuar vitet e punës nga secili punëdhënës). Për piken 2.2 - Diploma e gjeometrit , CV dhe kontrata e punës ose referenca të punëdhënësve që dëshmojnë përvojën e punës, (në referenca duhet të jete të saktësuar vitet e punës nga secili punëdhënës). Për piken 2.3.Certifikata e salduesit, CV dhe kontrata e punës. Për piken 2.1,2.2dhe 2.3 Nëse janë të angazhuar vetëm për këtë projekt duhet të prezantohen edhe marrëveshjet e bashkëpunimit. Për piken 2.4. –Një listë e emrave të punëtorëve të cilët e përbëjnë këtë ekip si dhe kontratat e punës VEREJTJE- Asnjë referencë nuk do të llogaritet nëse nuk janë të saktësuar vitet e punës
3. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose posedim pajisje teknike për realizim të suksesshëm të kontratës, minimalisht të ketë 3.1 Dy (2) kamion të tonazhit mbi 10 ton. 3.2 Dy (2) eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale 4-6 ton. 3.3 Një (1) ngarkues me kapacitet mbi 4 ton. 3.4 Një (1) papuçë për ngjeshje të tamponit me peshë deri 600 kg. 3.5 Një (1) makina për saldimin ballor të gypave të PE deri profili DN315 mm. 3.6 Një (1) makinë (sharrë) për prerje të asfaltit.	3.Një listë e pajisjeve nga Operatori Ekonomik. Listën e pajisjeve t'i bashkëngjiten këto dëshmi- kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (me validitet të regjistrimit) ose DUD – i doganor, ose fatura e blerjes (Ne rast se prezantoni fatura të blerjes, e ne të cilat nuk figurojnë pesha, atëherë këtyre faturave duhet t'ju bashkëngjiten edhe dokumentet percjellese në të cilat figurojnë pesha. Kjo vlen vetëm për ato pajisje që kërkojnë pesha). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofrojë marrëveshjen mbi qiramarrjen. Marrëveshja

	<p>duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimitë kontratës dhe duhet ti referohet aktivitetit ne fjale. Po ashtu marreveshes mbi qiramarrjen t'i bashkangjiten këto deshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (me validitet te regjistrimit) , ose DUD – i doganor, ose fatura e blerjes. (Ne rast se prezentoni fatura te blerjes, e ne te cilat nuk figuron pesha, atehere ketyre faturave duhet t'ju bashkengjiten edhe dokumentet percjellese ne te cilat figuron pesha. Kjo vlen vetem per ato pajisje qe kerkohet pesha)</p>
--	---

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</p> <p><i>Nëse po</i>, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse</p>
<p>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

<p>IV.1.1) Lloji i procedurës</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> E hapur</p> <p><input type="checkbox"/> E kufizuar</p> <p><input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata</p> <p><input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit</p>
<p>IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (<i>procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:</p>
<p>IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (<i>procedurë konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar</p> <p>Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë</p>

kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po Jo

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankandi elektronik: Po Jo

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

ose

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po Jo

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i
i

Po Jo

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:

data 04.04.2024 koha 13:00:00 vendi e-prokurimi

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

Po Jo

Nëse po, jep arsyetim **Ky tender ka qene i inicuar njehere ne dhjetor 2023 ,por ka deshtuar. Po ashtu edhe për shkak të punimeve që është duke bërë Komuna e Rahovecit në këto tre rrugë, e cila është duke bërë shtrirjen e gypave të rrjetit atmosferik, atëherë paralelisht do të bëhet dhe ndërrimi i gypave nga azbest-cimento në PE. Kjo për shkak se gypat aktual janë të vjetëruar dhe kanë defekte të shpeshta, duke rezultuar në humbje të ujit.**

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po Jo

<p><i>Nëse po</i>, vlera e sigurisë së tenderit 4300 Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muaj</p>
<p>IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: Deri më: data: ditët 60 apo muajt</p>
<p>IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve: data 04.04.2024 koha 13:00:00 vendi Kru, Gjakova'sha zyra e prokurimitnr 19</p>

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

1.Kërkesat për "informacione shitesë ose sqaruese" duhet të behën përmes platformës elektronike.
2.Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar në oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-se. **3.Vizita në vendpunishte me date 27.03.2024. Takimi në njesinë punuese në Rahovec në ora 10 00.**